



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 30

Datë 17 mars 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr. 8, datë 27.2.2014	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 62, datë 23.10.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 42, datë 16.11.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 615, datë 25.4.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	711
Vendim i GJK nr. 9, datë 27.2.2014	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5679, datë 17.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.....	715
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të vdekur të shtetasës Edlira Balliu.....	718
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Agim Grechke.....	718
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Petraq Kumati (Cami)...	718
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Nazmi Gazidedja.....	718

VENDIM
Nr. 8, datë 27.2.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 5.11.2013 mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura, çështjen me nr. 42/14 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ergus Dhima, përfaqësuar nga avokati Idajet Beqiraj, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, i vendimeve nr. 62, datë 23.10.2012, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 42, datë 16.11.2012, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 615, datë 25.4.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33/1, 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i KEDNJ-së dhe protokollin nr. 4 i KEDNJ-së; ligji nr. 8577 datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Besnik Imeraj, përfaqësuesin e kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 23, datë 9.6.2010, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kërkuari Ergus Dhima është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “trafikimit të narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim dhe, në përfundim të gjykimit, është dënuar me 6 vjet e 8 muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 43, datë 23.7.2010, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 354, datë 12.4.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit.

2. Gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor në të tri shkallët e gjykimit, kërkuari Ergus Dhima ka qenë në mungesë dhe është përfaqësuar nga mbrojtësit e caktuar me prokurën e posaçme të datës 16.10.2009. Nga kjo prokurë rezultoi se kërkuari është paraqitur personalisht para noterit, dhe ka caktuar dy përfaqësues ligjorë, avokatët I. M. dhe D. F., të cilët janë edhe mbrojtësit që kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, ndaj vendimit nr. 23, datë 9.6.2010, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Rezultoi, gjithashtu, se kërkuari, në bazë të vendimeve gjyqësore, është arrestuar në shtetin grek dhe në datën 5.7.2012 është ekstraduar në vendin tonë, i cili pretendohet edhe si momenti i marrjes dijeni nga ana e tij për procesin gjyqësor në ngarkim të tij dhe vendimet gjyqësore penale. Me pretendimin se prokuria e administruar në dosje ishte e falsifikuar, kërkuari, nëpërmjet mbrojtësit të tij, ka kërkuar rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit penal të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

3. Me vendimin nr. 62, datë 23.10.2012, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuari Ergus Dhima për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nr. 23, datë 9.6.2010, si të pambështetur në ligj e në prova. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 42, datë 16.11.2012, kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 615, datë 25.4.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit. Gjykatat kanë arsyetuar se megjithëse gjykimet janë zhvilluar në mungesë të kërkuarit, atij i janë garantuar e drejta për t’u njoftuar dhe mbrojtur, madje edhe për të paraqitur prova në gjykatën e apelit. Ndërsa, në lidhje me pretendimet për falsitetin e prokurës, gjykatat kanë arsyetuar se, për sa kohë nga mbrojtja nuk u paraqit asnjë akt i përpiluar në formën që kërkon ligji, për deklarimin e saj të falsifikuar, ky pretendim nuk qëndron.

II

4. **Kërkuari Ergus Dhima** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me kërkesën e datës 19.7.2013, për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore që kanë vendosur rrëzimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, si edhe të vendimeve penale që e kanë shqyrtuar çështjen në themel dhe e kanë dënuar atë. Ai pretendon se këto vendime kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në aspektet e mëposhtme:

4.1 Është cenuar e drejta për t’u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në gjykim, pasi kërkuari është gjykuar në mungesë, duke mos pasur dijeni për zhvillimin e procesit penal kundër tij.

4.2 Prokura që gjendet në dosjen gjyqësore, me anë të së cilës kërkuesi ka zgjedhur përfaqësuesin për procesin e themelit të zhvilluar në gjykatën e apelit, është e falsifikuar, çka provohet edhe nga akti i ekspertimit. Fakti që kërkuesi nuk ka autorizuar, personalisht, asnjë përfaqësues ligjor në atë gjykim, e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

4.3 Gjykata e shkallës së parë, duke shkelur të gjitha rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të kuptimit të provës, të objektit të provave, të marrjes së provave dhe të çmuarjes së provave, nuk pranoi dhe nuk e ka bërë pjesë përbërëse të dosjes gjyqësore aktin e ekspertimit grafik.

4.4 Baza ligjore ku është mbështetur kërkesa për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit në gjykatën e apelit, përveç nenit 147/2 të KPP-së, janë edhe dy vendimet e Gjykatës Kushtetuese, nr. 30, datë 26.11.2009, dhe nr. 30, datë 17.6.2010.

4.5 Është cenuar parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi gjyqtarët e gjykatës së shkallës së parë, që kanë shqyrtuar kërkesën për rivendosje në afat, kishin papajtuemëri me funksionin e gjyqtarit, në kuptim të nenit 15/1 të KPP-së, për arsye se janë të njëjtët gjyqtarë që kanë dhënë vendimin mbi themelin e çështjes, në po atë gjykatë.

5. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka paraqitur këto prapësime:

5.1 Kërkuesi është gjykuar në mungesë, jo për shkak të mosdijenisë së tij për procesin, por për shkak të heqjes dorë, vullnetarisht, nga e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

5.2 Kërkuesi, me anë të prokurës së posaçme të administruar në gjykim, ka caktuar personalisht dy avokatë si përfaqësues të tij, duke i konsideruar veprimet e kryera prej tyre të drejta, sikur t'i ketë kryer ai vetë.

5.3 Për sa i përket pretendimit se prokura është e falsifikuar, kërkuesi nuk ka shterur të gjitha mjetet ligjore, sipas kërkesave të nenit 131/f të Kushtetutës dhe, për këtë arsye, ai nuk mund të merret në shqyrtim nga kjo gjykatë. Për më tepër që kërkuesi nuk ka ezauruar dhe institutin e rishikimit, që e normojnë nenet 449, 450 e vijues të KPP-së.

5.4 Kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tij dhe pas redaktimit të prokurës prej tij është larguar me vullnet të lirë nga Shqipëria për në shtetin grek, duke zgjedhur me vullnet të lirë të mos marrë pjesë në procesin penal, me qëllimin për t'u fshehur drejtësisë.

5.5 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë, në kuptim të nenit 15/1/2 të KPP-së, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda nuk kanë dhënë dhe as nuk kanë marrë pjesë në dhënien e

vendimit në një shkallë tjetër të procedimit, apo në rigjykimin e çështjes pas prishjes së vendimit. Ata nuk kanë dhënë asnjë mendim lidhur me thelbin e çështjes dhe, për këtë arsye edhe ky pretendim është i pabazuar.

III Vlerësimi i Gjykatës

A. Për legjitimitimin e kërkuesit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese

6. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione materiae*, në kuptim të neneve 131/f dhe nenit 134/1/g të Kushtetutës. Ai legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", pasi vendimi i fundit gjyqësor, i dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, për këtë proces, mban datën 25.4.2013, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 17.7.2013, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar.

B. Për pretendimin për cenimin e të drejtës së mbrojtjes

7. Kërkuesi pretendon se nuk ka pasur dijeni për gjykimin e zhvilluar ndaj tij, për arsye se ai ndodhej jashtë shtetit dhe është vënë në dijeni për vendimet e dënimit vetëm në momentin që është ekstraduar në Shqipëri. Ai pretendon, gjithashtu, se prokura me të cilën ai është përfaqësuar në gjykim është e falsifikuar dhe, për këtë qëllim, ka paraqitur edhe një akt ekspertimi privat. Për pasojë, sipas tij, gjykatat duhej të pranonin kërkesën për rivendosjen në afat, në mënyrë që ai të kishte mundësi të mbrohej, në një gjykim të ri, ndaj akuzave të ngritura.

8. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor, është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka përcaktuar, ndër vite, disa standarde në lidhje me gjykimin në mungesë, sipas të cilave: a) i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm në procesin gjyqësor të kryer në ngarkim të tij; b) i pandehuri mund të heqë dorë vullnetarisht nga ushtrimi i kësaj të drejte; c) i pandehuri duhet të jetë në dijeni për ekzistencën e një procesi gjyqësor në ngarkim të tij; ç) duhet të ekzistojnë instrumente paraprake ose riparuese për të shmangur procese në ngarkim të të pandehurit, ose për të siguruar një proces të ri dhe, nëpërmjet depozitimit të provave të reja, të drejtën e mbrojtjes që nuk ka qenë e mundur të ushtrohet personalisht në procesin e zhvilluar në mungesë, të përfunduar tashmë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 30, datë 17.6.2010*).

9. Është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë, në mënyrë rigorozë, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve, sipas Gjykatës, është detyrë e organeve kompetente. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigorozë të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë, kur janë respektuar në mënyrë rigorozë dispozitat për njoftimin (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 45, datë 10.10.2011; nr. 26, datë 8.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri të ketë dijeni nëse ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Gjykata ka arritur në këtë përfundim, për arsye se heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar, duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimmarrjeje prej tij (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 45, datë 10.10.2011; nr. 26, datë 8.5.2012; nr. 39, datë 26.7.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata vlerëson se kërkuesit, gjatë procesit të gjykimin të kërkesës së tij për rivendosje në afat të ankimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, nuk i është shkëlur e drejta për t'u mbrojtur.

11. Në gjykim ai është përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar me prokurë dhe, në këtë kuptim, atij i janë garantuar të drejtat kushtetuese. Zgjidhja që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë dhënë kërkesës së kërkuesit, lidhur me rivendosjen në afat të ankimit, nuk bën pjesë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

12. Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuesi nuk arriti të provojë pretendimet e tij lidhur me cenimin e procesit të rregullt ligjor. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zhvilluar brenda standardeve procesin gjyqësor që lidhet me kërkesën për rivendosje në afat të ankimit.

13. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se sipas nenit 42 të Kushtetutës, e drejta për akses në gjykatë të referon tek e drejta që ka çdo individ për t'u drejtuar në gjykatën që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen. Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesin në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal

(*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 41, datë 28.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kërkuesi, në kuptimin kushtetues, ka pasur akses të plotë në gjykatë, në të gjitha shkallët e gjykimin. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zhvilluar procesin gjyqësor në prani të një mbrojtësi të caktuar prej tij me prokurë të posaçme, dhe konform të gjitha procedurave ligjore në fuqi. Kërkuesi jo vetëm ka realizuar të drejtën për t'u drejtuar gjykatës, për t'u dëgjuar prej saj, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje përfundimtare, përderisa ankimi i tij është shqyrtuar dhe konsideruar jo vetëm nga gjykata e Apelit, por edhe nga Gjykata e Lartë.

15. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson të pabazuar pretendimin e kërkuesit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë respektuar të gjitha parimet për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet zhvillimit të një gjykimi të drejtë, publik e të paanshëm.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë

16. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pasi kërkesa për rivendosjen në afat është shqyrtuar nga të njëjtët gjyqtarë që kanë gjykuar çështjen në themel, në kundërshtim me nenin 15 të KPP-së.

17. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 38, datë 15.10.2007; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 25, datë 11.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse,

të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie (shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 25, datë 11.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese).

18. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor (shih vendimin nr. 11, datë 5.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese). Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë roli i tij në mënyrë esenciale *pasiv* dhe *super partes* (shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 23, datë 4.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese). Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (shih vendimet nr. 10, datë 2.4.2009; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 47, datë 7.11.2011, të Gjykatës Kushtetuese).

19. Gjykata ka theksuar se paragjykimi eventual për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (shih vendimet nr. 12, datë 13.4.2007; nr. 15, datë 26.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese). Në rastin konkret, kërkuesi ka vënë në dyshim paanshmërinë e gjykatës, duke pretenduar se pjesëmarrja në shqyrtimin e kërkesës për rivendosi në afat, e të njëjtëve gjyqtarë që kanë gjykuar çështjen në themel, përbën cenim të këtij parimi.

20. Gjykata vëren se në dispozitat e KPP-së ligjvënësi, në mënyrë të qartë, nuk ka parashikuar asnjë normë apo rast papajtueshmërie lidhur me pjesëmarrjen e gjyqtarit në gjykimin e rivendosi në afat të së drejtës së ankimit. Vlerësimi që gjykata bën gjatë shqyrtimit në themel të çështjes (administrimi dhe vlerësimi i provave, analiza e elementeve të veprës penale me qëllim të dhënies së dënimit), është thellësisht i ndryshëm nga vlerësimi që bëhet në rastin e shqyrtimit të kërkesës për rivendosi në afat, i cili bazohet vetëm në vlerësimin e elementeve që kanë lejuar humbjen e afatit të paraqitjes së ankimit. Neni 15/1 i KPP-së parashikon papajtueshmërinë e gjyqtarit kur ai ka dhënë ose ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë tjetër të procedimit. Në rastin konkret, jo vetëm që nuk ndodhemi përpara një shkalle tjetër të procedimit, por ndodhemi para dy procedimeve të ndryshme, në të cilat gjyqtarit nuk i duhet të ndalet në të njëjtat vlerësime që kanë të bëjnë me përmbajtjen e të njëjtave fakte. Në këtë kuptim, qëllimi dhe natyra e veprimeve që këta gjyqtarë

kanë kryer në të dy gjykimet, nuk janë të tilla që të vënë në dyshim paanshmërinë e gjykatës.

21. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatës, është i pabazuar.

D. Për pretendimin se nga gjykatat nuk është vlerësuar drejt mënyra e marrjes dhe e çmuarjes së provave

22. Kërkuesi pretendon se gjykatat nuk kanë vlerësuar dhe çmuar drejt provat, pasi ato nuk e kanë pranuar pretendimin për falsitetin e prokurës, me arsyetimin se nga ana e mbrojtjes nuk është paraqitur asnjë akt i përpiluar në formën e kërkuar.

23. Referuar qëndrimeve konstante të Gjykatës, mënyra e vlerësimit dhe e çmuarjes së provave, si edhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, që zgjidhin çështjen konkrete, dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të kësaj Gjykate. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe, aq më tepër, të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete (shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 3, datë 19.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese). Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 34, datë 12.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

24. Për sa më sipër, edhe në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk e ka ngritur në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, ndaj ai është haptazi i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f”, dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

VENDIM
Nr. 9, datë 27.2.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha,	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina (Çinari) Basha, në datën 17.12.2013, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen me nr. 51/23 Akti, që i përket:

KËRKUES: Sinan Driza

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë;

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë;

Zyra Përmbartimore pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5679, datë 17.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131 shkronja “f”, 134 pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili kërkoj pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara Zyra Përmbartimore Tiranë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Komisioni Vendor i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i qarkut Tiranë (në vijim KVKKP) me vendimin nr. 183, datë 17.2.2006, i ka njohur trashëgimtarit Sinan Driza pronësinë në një sipërfaqe

truall prej 6700 m², e ndodhur në fshatin Prush Tiranë, duke i kthyer sipërfaqen prej 5450 m² dhe kompensuar sipërfaqen prej 1250 m².

2. KVKKP-ja e qarkut Tiranë, me shkresën nr. 217, datë 24.3.2006, i ka dërguar ZRPP-së Tiranë vendimin nr. 183, datë 17.2.2013 të KVKKP-së për të kryer veprimet përkatëse për regjistrim.

3. ZRPP-ja e qarkut Tiranë, me shkresën nr. 3357 prot., datë 12.6.2006, drejtuar KVKKP-së së qarkut Tiranë, ka sqaruar se nuk mund të kryejë regjistrimin e pronës pasi në planvendosjen e pronës mungojnë firmat e punonjësit që ka përgatitur planvendosjen dhe e kryetarit të komisionit. Me shkresën 950/1 prot., datë 6.7.2006, KVKKP-ja i ka kthyer përgjigje ZVRPP-së duke përcaktuar se vendimi është i vlefshëm edhe pa firmat e dy ish-punonjësve, të cilët janë larguar nga detyra. Kërkuari, pas ankimit në ZRPP-në e qarkut Tiranë, është njoftuar me shkresën nr. 639/1 prot., datë 25.8.2006, se duhet të paraqitet pranë këtij institucioni pas datës 10.9.2006, për të kryer veprimet përkatëse. Në kushtet kur përsëri ZRPP-ja nuk ka kryer asnjë veprim, kërkuari i është drejtuar me kërkesë ZQRPP-së. Ky institucion, me shkresën nr. 639/2 prot., datë 30.10.2006, e ka njoftuar se për të kryer veprimet për regjistrimin e pronës duhet të paraqitet në ZVRPP pas datës 10.9.2006.

4. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, kërkuari ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt detyrimin e Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për ndreqjen e pasaktësive në vendimin nr. 183, datë 17.2.2006, si dhe për regjistrimin e vendimit në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të qarkut Tiranë.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5679, datë 17.7.2007, i cili ka marrë formë të prerë në datën 1.8.2007, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

6. Me vendimin nr. 1560, datë 20.6.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për vendimin nr. 5679, datë 17.7.2007.

7. Zyra Përmbartimore Tiranë, me shkresën nr. 12247, datë 7.10.2008, e ka njoftuar palën debitorë për ekzekutimin vullnetar të vendimit.

8. Zyra Përmbartimore, me vendimin nr. 13395, datë 7.9.2009, e ka gjobitur Zyrën Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Tiranë/debitori, sepse ky institucion nuk ka marrë masat e nevojshme për ekzekutimin e vendimit.

9. Kundër këtij vendimi, Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të qarkut Tiranë ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt deklarimin e pavlefshëm të titullit të ekzekutimit dhe anulimin e vendimit për marrjen e gjobës ndaj saj.

10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1433, datë 26.2.2010, ka vendosur pushimin e gjykimit për mosparaqitjen e palës paditëse në seancë gjyqësore, pa shkak të arsyeshëm.

11. Kërkuesi i është drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Tiranë, me kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 183, datë 17.2.2006. AKKP-ja, me vendimin nr. 1336, datë 30.11.2011, ka vendosur deklarinimin e mungesës së kompetencës dhe juridiksionit për rishikimin e vendimit nr. 183, datë 17.2.2006, në respektim të vendimit nr. 43, datë 6.10.2011, të Gjykatës Kushtetuese, për shfuqizimin e kompetencave të AKKP-së për rishikimin e vendimeve.

12. Kundër këtij vendimi kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. 11495, datë 26.11.2012, ka vendosur rrezimin e padisë. Në datën 25.1.2013 ky vendim ka marrë formë të prerë.

II

13. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5679, datë 17.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda një afati të arsyeshëm.

14. **Subjekti i interesuar** Zyra Përmbartimore Tiranë, me shkresën nr. 6418 prot., datë 26.11.2013, paraqiti dosjen përmbartimore ku pasqyrohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e saj në funksion të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

15. **Subjektet e interesuara**, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, paraqitën prapësimet e tyre me shkrim për çështjen objekt shqyrtimi. Zyra përmbartimore ka parashtuar, në mënyrë të përmbledhur, duke argumentuar se nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor dhe inventarizimi i dosjeve të regjistrimit dhe hartografisë nuk rezulton që kërkuesi të ketë depozituar praktikë. Për të pasur të dhëna të sakta kërkohet përsëri paraqitja e kërkuesit pranë sporteleve të zyrës për të kryer aplikimin e nevojshëm për verifikimin e pasurisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

16. Gjykata Kushtetuese (në vijim Gjykata) ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës duhet

konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

18. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces.

19. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit dhe autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Çështja konkrete është vlerësuar në vijim nga Gjykata Kushtetuese, në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme.

i. Kompleksiteti i çështjes

21. Në çështjen në shqyrtim, në dispozitivin e vendimit nr. 5679, datë 17.7.2007 të Gjykatës së Rrethit

Tiranë, është përcaktuar detyrimi i Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për të ndrequr pasaktësitë në vendimin nr. 183, datë 17.2.2006 të KVKKP-së, si dhe regjistrimi në ZVRPP-në e qarkut Tiranë.

22. Gjykata çmon se nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së kërkuarit dhe i autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.

ii. Sjellja e kërkuarit

23. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimit të çështjes është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi para tejkallimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet me mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë për faj të veprimeve ose mosveprimeve të kërkuarit, duke sjellë tejkallimin e afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e caktuara nga ligji.

24. Për sa i përket sjelljes së kërkuarit, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave rezultojnë se kërkuari, pas mbarimit të procesit gjyqësor për ndreqjen e pasaktësive formale të vendimit nr. 183, datë 17.2.2006, të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i është drejtuar Zyrës Përmbartimore me kërkesë për ekzekutimin e vendimit nr. 5679, datë 17.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

25. Sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar dhe duke shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

iii. Sjellja e autoriteteve

26. Në këtë drejtim është e nevojshme të vlerësohet nëse Zyra Përmbartimore dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kanë marrë masat e nevojshme pas lëshimit të urdhrat të ekzekutimit, në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë.

27. Sipas kërkesës dhe dokumenteve të bashkëlidhura, rezultojnë se Zyra Përmbartimore ka ndërmarrë hapat e nevojshëm procedurale. Konkretisht, me shkresën nr. 9292 prot., datë 16.7.2008, i ka dërguar Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pranë qarkut Tiranë, lajmërim për ekzekutim vullnetar. Ndërsa me shkresën nr. 12247, datë 7.10.2008, i ka dërguar urdhrat për ekzekutimin e vendimit.

28. Në përgjigje të shkresës nr. 9292 prot., datë 16.7.2007 të Zyrës Përmbartimore, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me shkresën nr. 6972/1, datë 9.9.2008, ka kthyer përgjigje duke parashtruar se vendimi nr. 5679, datë 17.7.2007 i

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i detyrueshëm për zbatim nga pala e paditur dhe nuk përbën titull pronësie të detyrueshëm për zbatim.

29. Zyra Përmbartimore Tiranë, në mënyrë të përsëritur, konkretisht me shkresat nr. 3156 prot., datë 9.3.2009; nr. 5695, datë 21.4.2009; nr. 16359 prot., datë 19.11.2010; nr. 2289 prot., datë 10.4.2013; nr. 3158 prot., datë 20.5.2013, i ka kërkuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Tiranë, ekzekutimin e vendimit.

30. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me shkresën nr. 1133/1 prot., datë 13.3.2009, ka vënë në dijeni Zyrën e Përmbartimit lidhur me caktimin e grupit të punës për ekzekutimin e vendimit.

31. Zyra Përmbartimore, në datën 5.8.2009, ka shkruar për verifikim në zyrat e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Përgjegjësi i Zyrës juridike të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ka sqaruar se është bërë vlerësimi ligjor i çështjes dhe pritet konfirmim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për gjendjen e pronës në regjistrat e saj.

32. Zyra Përmbartimore Tiranë, me vendimin nr. 13395 prot., datë 7.9.2009, ka vendosur marrjen e masës së gjobës ndaj titullarit të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Tiranë, për mosekzekutim të vendimit nr. 5679, datë 17.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

33. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 10, datë 1.3.2012, dhe nr. 2, datë 1.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Sa më sipër, Gjykata thekson se është detyrim i debitorit që në çështjen konkrete të gjejë mundësitë e duhura për të ndrequr pasaktësitë e vendimit nr. 183, datë 17.2.2006, si detyrim që rrjedh nga vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 5679, datë 17.7.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

35. Në vështrim të fakteve të parashtruara më sipër, nga data 20.6.2008 e lëshimit të urdhrat të ekzekutimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pasur një korrespondencë të gjatë midis kreditorit dhe debitorit, duke tejzgatur afatin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, objekt gjykimi.

36. Në vlerësimin e Gjykatës, autoritetet shtetërore përgjegjëse kanë pasur kohën e mjaftueshme në dispozicion për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë. Debitori jo vetëm që nuk e ka bërë

këtë, por vazhdon të shprehet se nuk mund të kryejë veprimet e duhura në plotësim të detyrimeve të tij ndaj kreditorit. Nuk rezulton që sjelljet e kërkuarit ose të Zyrës Përmbartimore të jenë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Përkundrazi, kërkuari ka qenë aktiv në kërkimin e tij për rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar.

37. Në përfundim, Gjykata konstaton se në çështjen objekt shqyrtimi ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

Pranimin e kërkesës.

Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5679, datë 17.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1048, datë 28.1.2014, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasës Edlira Balliu, e bija e Bashkimit dhe e Nimetes, e datëlindjes 9.8.1977.

KËRKESË

Shtetasi Selamet Gjeçaj, i biri i Haderit dhe i Ervehesë, i datëlindjes 1.5.1939, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur të djalit të tij, shtetasit Agim Grechke.

KËRKUESI
Selamet Gjeçaj

KËRKESË

Shtetasja Kate Kumati (Cami), e datëlindjes 15.5.1941, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, shtetasit Petraq Kumati (Cami).

KËRKUESJA
Kate Kumati (Cami)

KËRKESË

Shtetasi Florian Gazidedja, i biri i Nazmiut dhe i Meros, lindur dhe banues në Fier, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier shpalljen të vdekur të babait të tij, shtetasit Nazmi Gazidedja.

KËRKUESI
Florian Gazidedja

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 12 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006